



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/34

Datë: 23.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.
2. Obligohen institucionet e Republikës së Kosovës të zbatojnë Programin nga pika 1. e këtij vendimi sipas aktiviteteve të parapara në planin e veprimit dhe në përputhje me fushat e veta të zbatimit.
3. Obligohet Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të monitoron zbatimin e tij, si dhe të raporton çdo vit tek Qeveria për zbatimin e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/34  
Datë: 23.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shpreh vullnetin dhe interesin që Ndërtesa e ish burgut të Prishtinës në rrugën "Luan Haradinaj" të shpallet muze.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që, në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike, dhe Ministrinë e Financave dhe Transfereve, në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, Ligjin Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës dhe me legjislacionin tjetër në fuqi, të zhvillojë të gjitha procedurat e nevojshme dhe t'i propozojnë Qeverisë themelimin e Muzeut nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, dhe Ministria e Financave dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë